



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:277889
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06774118

Rev.nr.572/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Milena Gjeriq dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: Sh. B. nga P., rr. ..., të cilin e përfaqëson Valdet Zeqiri avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, për anulimin e vendimit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3005/2023, të datë 13.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i paditurës: Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3005/2023, të datë 13.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2756/22 të datës 08.02.2023, është vendosur: I. Aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. B. nga P., Rr. ... II. Anulohet si i paligjshëm vendimi i të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës - Komisioni Përzgjedhës për Rekrutimin e Kandidatëve i datës 10.09.2019, dhe detyrohet e paditura që paditësin ta përfshijë në listën e pritjes të kandidatëve që kanë kaluar me sukses fazat e rekrutimit dhe seleksionimit, përfshirë fazën e kontrollimit mjekësor, deri në fazën e verifikimit të kaluarës, në konkursin pasues. III. Detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, që paditësit Sh. B. t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej

420 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit ligjor.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.3005/2023, të datës 13.06.2024, ka vendosur që të: Refuzohet si e pabazuar, ankesa të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2756/22 i datës 08.02.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të LPK-së, dhe aplikimit të gabueshëm të drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj revizionin, ashtu që të anulohet aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3005/2023, të datës 13.06.2024 dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2756/22 të datës 08.02.2023, dhe çështjen ta kthejë në rigjykim, ose ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Përgjigje në revizion ka paraqitur paditësi duke e kundërshtuar në tërësi revizionin e të paditurës, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, fillimisht më datë 07.10.2019, në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin për Çështje Administrative, ka parashtruar padi ndaj të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë, e cila me aktvendimin A.nr.2376/19 të datës 26.12.2019 është shpallur jokompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike.

Më datë 12.02.2020 lënda është regjistruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamentit të Përgjithshëm Civil, ku me padi është kërkuar anulim i vendimit të Komisioni Përzgjedhës për Rekrutimin e Kandidatëve të datës 10.09.2019, duke theksuar më saktësisht si në precizimin e padisë të bërë përmes parashtrësës së datës 18.11.2022.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.2756/22 të datës 08.02.2023, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht, si në dispozitivin e aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka administruar këto prova: Vendimin e Policisë së Kosovës të datës 10.09.2019, dëftesën e pagesës të datës 18.09.2019, raportin e analizave për paditësin të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, raportin e analizave për paditësin nga Klinika "...", në P. të datës 27.09.2019, raportin e analizave për paditësin të datës 23.09.2019 të lëshuar nga laboratorit klinik biokimik - hematologjik "...", në P., raportin e analizave për paditësin të lëshuar nga laboratorit "...", në P., të datës 18.09.2019, raportin e ekzaminimeve mjekësore të Policisë së Kosovës për paditësin, raportin e analizave për paditësin nga Klinika "...", në P., të datës 30.08.2019, raportin e analizave nga Klinika "...", në P., Procedurat

Standarde të Operimit të Policisë së Kosovës me nr. ..., raportin e analizave për paditësin të lëshuar nga laboratorin "...", të datës 18.02.2021 në P., raportin e analizave për paditësin të lëshuar nga laboratorin "...", të datës 18.01.2021 në P., mendimin të dhënë nga eksperti mjekësor në laboratorin e gjendjes emergjente në P. për paditësin të datës 20.01.2021.

Ka shtuar se nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa kontestuar se paditësi ka marr pjesë në procedurën e rekrutimit për punësim në pozitën e zyrtarit policor në Policinë e Kosovës me nr. të aplikacionit ... në vitin 2019. Nuk ishte kontestues as fakti që paditësi gjatë procedurës së përzgjedhjes i është nënshtruar kontrollit mjekësor më datë 30.08.2019, në Klinikën "...", në P., institucion ky i autorizuar nga e paditura për të kryer kontrollin mjekësor të kandidatëve për zyrtar policor, ku nga analizat e kryera për paditësin ka rezultuar vlera e acidit urik për të njëjtin prej ..., fakt ky i cili vërtetohet përmes raportit të analizave të datës 30.08.2019 të lëshuar nga Klinika "...", në P.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte nëse e paditura gjatë procedurës së kontrollit mjekësor të cilës i është nënshtruar paditësi, ka zbatuar standardet e përcaktuara të kontrollit mjekësor të përcaktuara me Procedurën Standarde të Operimit të Komisionit Përzgjedhës për Rekrutimin e Kandidatëve, për zyrtar policor dhe staf civil që nuk janë shërbyes civil me nr. ... të datës 01.03.2018, dhe me ... për Marrëdhënien e Policisë së Kosovës, dhe nëse me rastin e kryerjes së analizave mjekësore për paditësin është vërtetuar drejt gjendja faktike nëse paditësi vuan nga acidi urik dhe nëse i njëjti ka përmbushur standardet e përshtatshmërisë mjekësore për ti kryera detyrat e zyrtarit policor.

Gjykata e shkallës së parë nga vendimi i të paditurës i datës 10.09.2019, gjeti se e paditura - Komisioni Përzgjedhës për Rekrutimin e Kandidatëve, përmes këtij vendimi ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit me nr. të aplikacionit ... dhe ka lënë në fuqi rezultatin e ekzaminimit mjekësor të "Klinikës ...", ku për paditësin është dhënë konstatimi se nuk është i aftë për kryerjen e detyrave të zyrtarit policor për shkak të diagnozës "...". Sipas këtij vendimi paditësi pas kontrollit mjekësor të kryer në hapësirat e Klinikës "...", në cilësinë e institucionit të autorizuar për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore nga PK, nuk ka arritur të përmbushë standardin e përcaktuar sipas Procedurës Standarde të Operimit nr. ..., Skesioni ..., pika..., ku parashihet që kandidati duhet të ketë aftësi shëndetësore për të kryer funksionet kryesore në vendin e punës në polici.

Nga raporti i analizave për paditësin të datës 18.09.2019, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë rezulton se acidi urik për paditësin ka dal në vlerë prej 150, ku vlera normale për meshkuj është M-140-420.

Nga raporti i analizave i datës 18.09.2019, i lëshuar nga Laboratori Mjekësor Biokimim-Hematologjik "...", në P., gjykata gjeti se po më datë 18.09.2019, vlera e acidit urik për paditësin ka rezultuar ... ku vlera normale është prej 140-420.

Nga raporti i analizave i datës 27.09.2019, i lëshuar nga Klinika "...", për paditësin gjykata gjeti se me këtë datë vlera e acidit urik për paditësin ka rezultuar ... ku vlera referente - normal për meshkuj është 202.3-416.5.

Nga raporti i analizave i datës 23.09.2019, për paditësin i lëshuar nga Laboratori Klinik Biokimik - Hematologjik "...", në P., rezulton se vlera e acidit urik për paditësin ka dal 395, ku vlera normal për meshkuj sipas këtij raporti është nga 150-420.

Nga raporti i analizave për paditësin i datës 18.01.2021, i lëshuar nga Laboratori "...", në P., rezulton se vlera e acidit urik e paditësit me këtë datë ka rezultuar 243, ku vlera normale është nga 208-428.

Nga raporti i analizave për paditësin i datës 18.01.2021 i lëshuar nga Laboratori "...", në P., rezulton se vlera e acidit urik e paditësit me këtë datë ka rezultuar 233.6, ku vlera normale është 140-420.

Gjykata e shkallës së parë me qëllim të sqarimit dhe vërtetimit të faktit nëse vlera e acidit urik e paditësit sipas rezultatit të analizave të Klinikës "...", në P. të datës 30.08.2019, ka qenë momentale, nëse kjo vlerë ndryshon dhe për çfarë arsye mund të ndryshoj, duke vepruar sipas propozimit të palës paditëse në seancën e datës 24.12.2020, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë, ashtu që ka caktuar ekspertin A. G. - kryetëknik laborant në Laboratorin e QKUK-së - Qendra Emergjente në P., për ta kryer ekspertizën mjekësore dhe për ta dhënë mendimin me shkrim. Eksperti mjekësor i caktuar nga gjykata në ekspertizën me shkrim dorëzuar gjykatës të datës 20.01.2021, ka dhënë konstatimin dhe mendimin profesional sipas të cilit një nga ekzaminimet e arthritit të shkaktuar nga acidi urik apo artheritis urica (gout disease) është testimet laboratorike dhe një nga parametrat kryesor është niveli i acidit urik. Bazuar nga të dhënat praktike por dhe të studimeve shkencore niveli i acidit uridik rreth 20% mbi vlerën normale dhe i një matje të vetme nuk e konfirmon aspak sëmundjen si të tillë. Eksperti ka dhënë mendimin se duke mos e kontestuar saktësinë laboratorike të vlerës së acidit urik në të cilën është bazuar përjashtimi i kandidatit Sh. B. në konkursin e Ministrisë së Punëve të Brendshme bëjmë me dije se vlera e acidit urik në atë interval është lehtë e ndikueshme dhe nga faktorë të jashtëm. Kjo do të thotë se vlera e fituar e acidit urik është vetëm e një momenti, apo periudhe të shkurtër kohore, gjë të cilën e kanë nxjerrë në pah matjet që janë bërë në intervale të ndryshme kohore. Faktorët të cilët mund ta rrisin në mënyrë të moderuar acidin urik, janë ushqimet me përmbajtje të lartë proteinash, veçanërisht ato në bazë të purinave, barnat si aspirina, ciklosporinat, disa prej antihypertensive, përdorimi i alkoolit, aktiviteti i lartë fizik, ekspozimi ndaj elementeve toksike, të ambientit, etj, të gjitha këta faktorë janë relative sa i përket vlerave të moderuara, të acidit urik në gjak, pasi që me eliminimin e tyre, si faktor risku dhe vlerat e acidit urik janë të kthyeshme. Këtë mendim dhe konstatim të ekspertit mjekësor i cili punon si kryelaborant në Qendrën Emergjente në QKUK-në P., gjykata në tërësi ia fali besimin dhe e mori parasysh me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike, pasi që kjo ekspertizë mjekësore ishte profesionale dhe e argumentuar, e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna konkrete lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Ka theksuar se pas shqyrtimit të provave të administruara në këtë çështje kontestuese, gjykata gjen se e paditura, në mënyrë të kundërligjshme i ka refuzuar paditësit ankesën me vendimin e datës 10.09.2019, për shkak se, paditësi gjatë fazës së kontrollimit mjekësor ka dështuar të përmbush kriteret e përcaktuara në Procedurën Standarde të Operimit nr. ..., duke ju referuar Seksionit VI, pika E, paragrafi 7, ku parashihet se kandidati duhet të këtë aftësi shëndetësore për të kryer funksionet kryesore në vendin e punës në polici.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar Seksioni VI, pika E, paragrafi 7, të Procedurës Standarde të Operimit (Procedurës së rekrutimit dhe seleksionimit për zyrtarët policor dhe staf civil që nuk janë shërbyes civil), nenit 20 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr.04/2017 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës Për shpenzimet e procedurës ju ka referuar nenit 449, 452 paragraf 1 dhe 453 lidhur me nenin 463.1 dhe 2 të LPK-së të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.3005/2023, të datë 13.06.2024, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e të paditurës si të pathemeltë, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjendja faktike në mënyrën siç u theksuar si më lartë, është vërtetuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara.

Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vet veten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet ligjore siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike me decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra

në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata Supreme pranon qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta dhe arsyetimit që është dhënë sa i përket anulimit si të paligjshëm të vendimi të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës - Komisioni Përzgjedhës për Rekrutimin e Kandidatëve i datës 10.09.2019 dhe detyrimin paditësin ta përfshijë në listën e pritjes të kandidatëve që kanë kaluar me sukses fazat e rekrutimit dhe seleksionimit, përfshirë fazën e kontrollimit mjekësor, deri në fazën e verifikimit të kaluarës, në konkursin pasues, për arsye se:

Me nenin 49 paragrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se: “1. E drejta e punës garantohet”. “2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.

Me dispozitën e Seksionit VI, pika E, paragrafi 7 të Procedurës Standarde të Operimit nr.PSO-5.07, parashihet se: “ Mjeku duhet të kryejë një kontrollim adekuat shëndetësor për të zbuluar dëshmi mbi paaftësinë shëndetësore apo sëmundje që do ta kishin penguar kandidatin për të kryer funksionet kryesore në vendin e punës në Polici, për të cilin ai apo ajo ka konkurruar”.

Me dispozitën e nenit 20 paragrafi 1 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.04/2017 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, parashikohet se: “ 1.Kriteret dhe standardet për kontrollim mjekësor përcaktohen nga Drejtoria e Shërbimeve shëndetësore”, “2. Kandidatët të cilët dështojnë në kontrollin mjekësor kanë të drejtë ankese në Komisionin Përzgjedhës, brenda pesë ditëve të punës pas publikimit të rezultatev”.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, lidhur me sa i përket anulimit si të paligjshëm të vendimi të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës - Komisioni Përzgjedhës për Rekrutimin e Kandidatëve i datës 10.09.2019 dhe detyrimin paditësin ta përfshijë në listën e pritjes të kandidatëve që kanë kaluar me sukses fazat e rekrutimit dhe seleksionimit, përfshirë fazën e kontrollimit mjekësor, deri në fazën e verifikimit të kaluarës, në konkursin pasues, për arsye se paditësit në mënyrë të kundërligjshme i është mohuar e drejta e punësimit, ngase nuk është vërtetuar se i njëjti ka probleme shëndetësore dhe vuan nga acidi urik dhe nëse i njëjti nuk ka përmbushur standardet e përshtatshmërisë mjekësore për ti kryera detyrat e zyrtarit policor. Kjo vërtetohet nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të cilat janë administruar nga ana e gjykatës së shkallës së parë siç janë: raporti i analizave për paditësin të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, raporti i analizave për paditësin nga Klinika “...”, në P. të datës 27.09.2019, raporti i analizave për paditësin të datës 23.09.2019 të lëshuar nga laboratorit klinik biokimik - hematologjik “...”, në

P., raporti i analizave për paditësin të lëshuar nga laboratoritë "...", në P. të datës 18.09.2019, raporti i ekzaminimeve mjekësore të Policisë së Kosovës për paditësin, raporti i analizave për paditësin nga Klinika "...", në P. të datës 30.08.2019, raporti i analizave nga Klinika "...", në P., raporti i analizave për paditësin të lëshuar nga laboratoritë "...", të datës 18.02.2021 në P., raporti i analizave për paditësin të lëshuar nga laboratoritë "...", të datës 18.01.2021 në P. .

Gjithashtu kjo çështje është vërtetuar edhe me mendimin e dhënë nga eksperti mjekësor në laboratorin e gjendjes emergjente në P., për paditësin të datës 20.01.2021, me të cilin ka përcaktuar se: Një nga ekzaminimet e arthritit të shkaktuar nga acidi urik apo artheritis urica (Gout disease) është testimet laboratorike dhe një nga parametrat kryesore është niveli i acidit urik. Bazuar nga të dhënat praktike por dhe të studimeve shkencore niveli i acidit urik rreth 20% mbi vlerën normale dhe i një matje të vetme nuk e konfirmon aspak sëmundjen si të tillë. Duke mos e kontestuar saktësinë laboratorike të vlerës së acidit urik në të cilën është bazuar përjashtimi i kandidatit atë interval është lehtë e ndikueshme dhe nga faktorë të jashtëm. Kjo do të thotë se vlera e fituar e acidit urik është vetëm e një momenti apo periudhë të shkurtër kohore, gjë të cilën e kanë nxjerrë në pah matjet që janë bërë në intervale të ndryshme kohore. Faktorët që mund ta rrisin në mënyrë të moderuar acidin urik janë ushqimet me përmbajtje të lartë proteinash veçanërisht ato me bazë të purinave, barnat si aspirina, ciklosporinat, disa prej antihipertensive, përdorimi i alkoolit, aktiviteti i lartë fizik, ekspozimi ndaj elementeve toksik të ambientit etj. Të gjithë këta faktorë janë relative sa i përket vlerave të moderuara të acidit urik në gjak pasi që me eliminimin e tyre si faktorë rrisin dhe vlerat e acidit urik janë të kthyeshme. Andaj Gjykata Supreme kësaj ekspertize ia fali besimin e plotë, si profesionale dhe e paanshme.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.572/24, datë 27.01.2025.

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi